



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:249899
Datë: 26.11.2024
Numri i dokumentit: 06530184

KE.nr.377/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen juridike të paditësit “Alternativa” subjekti politik me seli në rrugën UÇK, kompleksi Qafa nr.1 në Prishtinë, kundër të paditurit “Lidhja Demokratike e Kosovës” subjekt politik me seli në rrugën UÇK 2B, Qafa në Prishtinë, i cili përfaqësohet në bazë të prokurës nga avokat Daut Rudi me seli në bulevardin Ismajl Raka në Kaçanik, me objekt kontesti kthimi i mjeteve financiare, vlera e kontestit 49,777.05€, jashtë seancës më 25 nëntor 2024, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditësit “Alternativa” subjekti politik me seli në Prishtinë, kundër të paditurit “Lidhja Demokratike e Kosovës” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kthimi i mjeteve financiare.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm.

ARSYETIM

Paditësi me datë 14.08.2019 ka paraqitur padi për kthim të mjeteve financiare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Ekonomik, kundër të Paditurit, me të cilën ka kërkuar të detyrohet e Paditura që t’i paguaj-kthej mjetet në shumë të përgjithshme prej 49,777.05€, me propozim për caktim të masës së përkohshme të sigurimit.

Kjo gjykatë gjatë shqyrtimit të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën e vet lëndore dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 para. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”*, vlerëson se si subjekte të pranuar me LGjK për ta zhvilluar kontestin tregtar janë (i) dy apo më shumë shoqëri tregtare të cilat janë palë kundërshtare me njëra tjetrën në atë kontest (*çdo kontest mes shoqërive tregtare*), (ii) njëra palë të jetë shoqëri tregtare ndërsa pala tjetër kundërshtare të jetë subjekt publik (*çdo kontest mes shoqërive tregtare dhe subjekteve publike*), dhe (iii) në konfliktin administrativ të jetë e përfshirë të paktën një shoqëri tregtare (*të gjitha konfliktet administrative të shoqërisë tregtare*).

Meqenëse në rastin konkret çështja juridike kontestimore zhvillohet në mes të Paditësit si subjekt politik dhe të Padituri si subjekt politik, atëherë këto dy subjekte nuk mund të kenë kontest tregtar në kuptim të LGjK-së ndërmjet vete, rrjedhimisht kjo çështje nuk bie në kompetencën lëndore të kësaj gjykate për vendosje, ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.377/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese ndaj këtij aktvendimi brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimet. Ankesa në formë të shkruar dhe në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.